



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RREGULLA PËR TAKSAT

Prishtinë, 2017



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7, Nenin 24 paragrafin 7, Nenin 26 dhe Nenin 58 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur me datë2017 miratoi:

RREGULLËN PËR TAKSAT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulle është që t'i specifikojë llojet dhe shumën e taksës të përcaktuar në Nenet 23 dhe 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me qëllim të mbledhjes së të hyrave për Zyrën e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: Rregullatori).

Neni2

Fushëveprimi

Kjo rregull përcakton procedurën dhe afatet përfundimtare për pagim të taksave, si dhe pasojat për mospagim të taksave.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **“ZRRE”** - nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji.
 - 1.2 **“Taksë Fillestare e Licencimit”** - nënkupton pagesën e taksës fillestare, e cila është e pakthyeshme e që duhet të paguhet nga aplikuesi në rastin e dorëzimit të Aplikacionit për licencim.
 - 1.3 **“Taksë Vjetore e licencimit”** - nënkupton pagesën e taksës vjetore, që duhet të paguhet në baza vjetore nga disa të licencuar (shih shtojcën 1 të kësaj rregulle).
 - 1.4 **“Taksë për shqyrtim të aplikacioneve për autorizime”**- nënkupton pagesën e taksës për shqyrtim të aplikacioneve, e cila është e pakthyeshme që duhet të paguhet nga aplikuesi në rastin e dorëzimit të Aplikacionit për autorizim.
 - 1.5 **Zyra e Rregullatorit për Energji** - (në tekstin e mëtejme: Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.



Shprehjet e përdorur në këtë Rregull, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjisë Elektrike, Ligjin për Ngrohje Qendrore, Ligjin për Gazin Natyror dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 4

Llojet e Taksave

1. Sipas Nenit 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori mbledhë taksat si në vijim:
 - 1.1 Taksën fillestare të licencimit;
 - 1.2 Taksën për modifikimin dhe ndryshimin e licencave dhe aplikacioneve tjera për licenca;
 - 1.2. Taksën vjetore të licencimit;
 - 1.3. Taksën për lëshimin e certifikatave të origjinës;
 - 1.4. Taksën për zgjidhjen e kontesteve administrative;
 - 1.5. Taksën për rishikim të aplikacioneve dhe
 - 1.6. Taksën për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim dhe licencim.

Neni 5

Parimet e përgjithshme në lidhje me përlogaritjen e taksës

1. Me përjashtim të taksës vjetore të licencimit, taksat e caktuara sipas kësaj Rregulle do të përlogariten, në përputhje me shpenzimet administrative të bëra në mënyrë të arsyeshme gjatë procedimit të akteve ndaj të cilave referohen këto taksa.
2. Taksat vjetore do të vendosen në mënyrë që të mundësohet vetë qëndrueshmëria financiare dhe veprimi efektiv e efikas në kosto të Zyrës së Rregullatorit për Energji për të arritur qëllimet adekuate me autoritetet rregullative që veprojnë në rrethana të ngjashme dhe që në asnjë rast nuk tejkalojnë shumën e 2% (dy përqindëshit) të qarkullimeve bruto të ndërmarrjeve të energjisë të cilave u kërkohet të paguajnë taksa të tilla.

Neni 6

Shuma e taksës

Shuma e saktë e taksave të duhura do të përcaktohet në përputhje me Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të kësaj Rregulle.

KREU II



KATEGORITË E TAKSAVE

Neni 7

Taksa fillestare e licencimit

1. Taksë fillestare e Licencimit është taksa e përcaktuar për nxjerrjen e licencës, përfshirë shpenzimet për përgatitjen e licencës, për kryerjen e aktivitetit në sektorin e energjisë.
2. Taksa fillestare e Licencimit përfshinë shumën fikse të taksës, si në shtojcën 1 të kësaj rregulle.

Neni 8

Taksa për modifikimin dhe ndryshim të licencave

1. Taksë për modifikim/ndryshim apo vazhdim të licencave është taksa që përfshinë shpenzimet për modifikim/ndryshim apo vazhdim të licencës, për kryerjen e aktivitetit të energjisë.
2. Taksa për modifikim, ndryshim dhe vazhdim të licencave përfshinë shumën fikse të taksës, si në shtojcën 1 të kësaj rregulle.

Neni 9

Taksa vjetore e licencimit

1. Taksat vjetore të licencimit janë taksat e përshkruara për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e energjisë dhe përlllogariten çdo vit pasues pas vitit të licencimit.
2. Përlllogaritja e taksave vjetore të licencave, e paraqitur në Shtojcën 1 të kësaj rregulle, merr parasysh kushtet e sektorit të energjisë në Kosovë dhe bazohet në kriterin e aplikueshmërisë dhe thjeshtësisë, si dhe synon të shmangë çdo rrezik të mbingarkesës financiare për konsumatorët.
3. Taksa vjetore e licencimit, do tu ngarkohet të gjithë prodhuesve të energjisë dhe importuesve të energjisë dhe do të përlllogaritet mbi bazat e futjes (injektimit) të energjisë neto në rrjet.
4. Rregullatori do të përlllogarisë taksën vjetore të licencimit mbi bazë të vlerësimeve të rrjedhave të energjisë gjatë vitit aktual. Në fillim të vitit të ardhshëm, Rregullatori do të rillogarisë taksën e duhur vjetore bazuar në rrjedhat aktuale të energjisë, siç parashihet sipas kushteve të Kodit Matës. Qartësimi/përshtatja e çdo dallimi midis shumës së parapaguar dhe dhe asaj reale do të bëhet gjatë pagimit të taksës vjetore të licencimit për vitin e ardhshëm.

Neni 10

Taksa për Lëshimin e certifikatës së origjinës

1. Taksa për nxjerrjen e certifikatave të origjinës, përfshinë shpenzimet për përgatitjen e këtyre certifikatave.
2. Taksa për nxjerrjen e certifikatave të origjinës përfshinë shumën fikse të taksës, si në shtojcën 1 të kësaj rregulle.



Neni 11

Taksa për zgjidhjen e kontesteve administrative

1. Taksa për Zgjidhjen e Kontesteve Administrative është taksë për shqyrtim të kontesteve nga ana e , në përputhje me Rregullën për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
2. Taksat për Zgjidhjen e Kontesteve Administrative përfshinë shumën fikse të taksës, si në shtojcën 1 të kësaj rregulle.
3. Konsumatorët shtëpiak përjashtohen plotësisht nga detyrimet e pagimit të taksave për zgjidhjen e kontesteve administrative.

Neni 12

Taksa për rishikim të aplikacioneve

1. Kjo taksë përfshinë shpenzimet për rishikim të aplikacioneve për kryerjen e aktivitetit të energjisë.
3. Taksa për rishikim të aplikacioneve përfshinë shumën fikse të taksës, si në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të kësaj rregulle.

Neni 13

Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim dhe licencim

1. Kjo taksë përfshinë shpenzimet për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për kryerjen e aktivitetit të energjisë.
4. Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizime dhe licencim përfshinë shumën fikse të taksës, si në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të kësaj rregulle.

KREU III

PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Neni 12

Procedura për mbledhjen e taksave

1. Taksa për shqyrtimin e aplikacioneve do të paguhet në kohën e dorëzimit të aplikacionit, pasi që Rregullatori të lëshojë një Faturë për pagesë të taksës.
2. Taksa fillestare e licencimit dhe taksa për nxjerrjen e certifikatave të origjinës, do të paguhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike prej marrjes së faturës të lëshuar nga Rregullatori.
3. Taksa vjetore e licencimit do të paguhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike , prej marrjes së faturës të lëshuar prej Rregullatorit. Rregullatori mund të lejojë pagimin e këtyre taksave edhe përmes pagesave me këste mujore.



4. Taksa për zgjidhjen e kontesteve administrative do të paguhet në kohën e dorëzimit të ankesës/kërkesës në Rregullator.
5. Taksa për rishikim të aplikacioneve do të paguhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike , prej marrjes së faturës të lëshuar prej Rregullatori.
6. Taksën për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim dhe licencim dhe të paguhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike , prej marrjes së faturës të lëshuar prej Rregullatorit.

Neni 13

Mënyrat e pagimit

1. Të gjitha taksat do të paguhet dhe depozitohen në llogarinë zyrtare (bankare) të Rregullatorit, të krijuar nga Drejtorati i Përgjithshëm i Thesarit.
2. Për çdo pagesë të depozituar, fatura e depozitimit do të dorëzohet në Rregullator.

Neni 14

Pasojat e mospagimit

1. Rregullatori ka të drejtën të refuzojë shqyrtimin e aplikacioneve për nxjerrjen ose ndryshimin e licencave, nëse aplikuesi nuk e kryen pagesën e faturës së taksave të duhura.
2. Rregullatori ka të drejtë të refuzojë zgjidhjen e kontesteve, në rast të mospagimit të taksave të përcaktuara me këtë rregull.
3. Në rast se nuk arrihet të bëhet pagesa e taksës sipas kushteve të kësaj Rregulle, Rregullatori do të njoftojë me shkrim debitorin, duke i siguruar edhe një afat përfundimtar prej të paktën dhjetë (10) ditë kalendarike dhe jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike. Në rast të mospagimit deri në skadimin e këtij afati, Rregullatori mund të refuzojë shqyrtimin e aplikacioneve dhe ankesave/kërkesave për zgjidhje të kontesteve, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Në rast të mospagimit të taksës vjetore, Rregullatori do të ndër marr të gjitha masat ligjore të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Për masat e ndërmarra nga Rregullatori, i licencuari do të njoftohet me shkrim.

Neni 15

Ankesat në Rregullator

1. Debitori i taksës, pas marrjes së njoftimit mbi taksën përkatëse, ka të drejtë të ankohet në Rregullatori, brenda afatit prej katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike.
2. Rregullatori është e detyruar të regjistrojë këtë ankesë dhe të vendosë në lidhje me të, brenda një afatit prej katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike.
3. Dorëzimi i një ankese, nuk pezullon detyrimin për të paguar taksën, përveç nëse lejohet ndryshe nga Rregullatori.



4. Rregulatori mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për të paguar taksën, deri në një vendim përfundimtar mbi ankesën. Në këtë rast, debitori do të njoftohet me shkrim.
5. Pezullimi i detyrimit për të paguar taksën do të lejohet në rast të ankesave të justifikuara si duhet.

KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Gjuha Zyrtare

Kjo Rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 17

Ndryshimi

1. Rregulatori mban të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 18

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 19

Shfuqizimi

Kjo Rregull shfuqizon Rregullën për Taksat e nxjerrë në qershor 2011, dhe Vendimin V_168_2009 i datës 01 prill 2009, të hartuar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Ligji Nr. 03/L-185,

Neni 20

Hyrja në Fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Krenar Bujupi, U.D Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejfiqaj, Anëtar

DRAFT

**SHTOJCA 1: TABELË PËR KATEGORI TË TAKSAVE**

KATEGORITË E TAKSAVE PËR LICENCIM	Taksat në EURO
A. TAKSË FILLESTARE E LICENCIMIT PËR:	
A1. PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE	
A1.1 0 MW deri 50 MW	1,000. ⁰⁰ €
A1.2 51 MW deri 400 MW	1,500. ⁰⁰ €
A1.3 mbi 400 MW	3,000. ⁰⁰ €
A2. FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE	
A2.1 deri në 50 MW	1,000. ⁰⁰ €
A2.2 prej 50 deri 100 MW	1,500. ⁰⁰ €
A2.2 tejkalon 100 MW por më e vogël se 400 MW	2,000. ⁰⁰ €
A2.3 mbi 400 MW	3,000. ⁰⁰ €
A3. OPERATOR TË TREGUT	1,000. ⁰⁰ €
A4. LICENCIM I OST DHE OSSH	1,000. ⁰⁰ €
A5. PRODHIM TË NGROHJES QENDRORE	500. ⁰⁰ €
A6. SHPËRNDARJE TË NGROHJES QENDRORE	500. ⁰⁰ €
A7. FURNIZIM ME NGROHJE QENDRORE	500. ⁰⁰ €
A8. FURNIZIM ME SHUMICË (TREGTIM) ME ENERGJI ELEKTRIKE	
A8.1 0 MW deri 100 MW	1,000. ⁰⁰ €
A8.2 101 MW deri 400 MW	1,500. ⁰⁰ €
A8.3 mbi 400 MW	3,000. ⁰⁰ €
B. TAKSË PËR MODIFIKIM/NDRYSHIM/VAZHDIM LICENCE	1,000. ⁰⁰ €
C. TAKSË VJETORE E LICENCIMIT	
C1. PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE, IMPORTI <i>(futja neto në rrjet për gjeneratorët dhe energjia e kontraktuar dhe e realizuar për tregtarët ndërlidhës)</i>	€ 0.22/MWh
C.1.1 PRODHIM I ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BRE-të	€ 0.10/MWh
C2. PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE <i>(futja neto në rrjet)</i>	€ 0.10/MWh
D. TAKSË PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATATËS SË ORIGINËS	€ 0.00/MWh
E. TAKSË PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE	0,00. ⁰⁰ €



SHTOJCA 2: TABELË PËR KATEGORI TË TAKSAVE

KATEGORITË E TAKSAVE PËR AUTORIZIM	Taksat në EURO
A. TAKSË PËR SHQYRTIM TË APLIKACIONEVE PËR AUTORIZIM:	
Gjenerator i ri me kapacitet 1 kW deri 100 kW	500. ⁰⁰ €
Gjenerator i ri me kapacitet 101 kW deri 5 MW	1,000. ⁰⁰ €
Gjenerator i ri me kapacitet mbi 5 MW deri 10 MW	2,000. ⁰⁰ €
Gjenerator i ri me kapacitet mbi 10 MW deri 50 MW	3,000. ⁰⁰ €
Gjenerator i ri me kapacitet mbi 50 MW deri 100 MW	5,000. ⁰⁰ €
Gjenerator i ri me kapacitet mbi 100 MW	10,000. ⁰⁰ €
B. TAKSË PËR MODIFIKIMIN/NDRYSHIMIN E AUTORIZIMIT	1,000. ⁰⁰ €